FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

EUFILINE

Tretësirë për injeksion – (202 mg + 50.5 mg) / 10 ml (2.5 %)
Tretësirë për injeksion – (192 mg + 48 mg) / 2 ml (12 %)
(Teofilinë, Etilendiaminë)

EUFILINE

Drazhe – 100 mg
(Aminofilinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Eufiline dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Eufiline
3. Si ta merrni Eufiline
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Eufiline
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË EUFILINE DHE PËRSE PËRDORET

Aminofilina është një kompleks i teofilinës me etilendiaminën; kjo e fundit përmirëson tretshmërinë dhe përthithjen e teofilinës. Aminofilina lëshon drejpërsëdrejti muskulaturën e bronkeve dhe të enëve të gjakut të mushkërive, nxit sistemin nervor qendror, nxit diurezën, shton sekretimin acid të stomakut, ul trysninë e pjesës së poshtme të sfinkterit ezofageal dhe frenon tkurrjet uterine. Teofilina është edhe një nxitës qendror i frymëmarrjes.

Eufiline përdoret: për trajtimin dhe profilaksinë e bronkospazmave të prapësueshme të shoqëruara me astmë ose sëmundje pulmonare obstruktive kronike.

2. PËRPARA SE TË MERRNI EUFILINE

Mos merrni Eufiline:

- në qoftë se keni mbindjeshmëri ndaj ksantinave (teofilinë, kafeinë, teobrominë), etilendiaminës ose ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij bari;
- në qoftë se vuani nga epilepsia (mund të ulë pragun konvulsiv);
- në qoftë se keni takiaritmi;
- në rast infarkti akut miokardi;
- në qoftë se vuani nga porfiria akute.

Aminofilina intravenoze duhet të shmanget në pacientët që janë duke marrë teofilinë, aminofilinë ose preparate të tjera që përmbajnë ksantina.

Eufiline nuk rekomandohet të përdoret tek fëmijët nën 1 vjeç.

Tregoni kujdes të veçantë me Eufiline

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Eufiline.
Aminofilina duhet përdorur me kujdes:

- në pacientët me ulçer peptike, hipertiroidizëm, diabet, glaukomë, hipertension, ose sëmundje të tjera kardiovaskulare;
- në pacientët që vuajnë nga sëmundjet e zemrës (angina pektoris, aritmi, insufiçiencë kardiake), disfunksionim i mëlçisë dhe i veshkave, sëmundje akute febrile;
- në të moshuarit, duhanpirësit dhe konsumuesit e alkoolit;
- gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji.

Injektimi intravenoz i aminofilinës duhet të kryhet shumë ngadalë në mënyrë që të parandalohen efektet e rrezikshme në sistemin nervor qendror dhe atë kardiovaskular.
Duhet shmangur dozimi i tepërt në pacientët obezë si dhe doza duhet të llogaritet në bazë të peshës ideale trupore për gjatësi.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Eufiline.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Eufiline në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- lëndë që mund t'i ulin nivelet e teofilinës, siç janë: aminoglutetimidi, barbituratet, hidantoinat, karboni, karbamazepina, izoniazidi, diuretikët e ansës, ketokonazoli, rifampicina, tymi i duhanit, sulfinpirazoni, simpatomimetikët (beta – agonistët dhe tioaminat), ritonaviri;
- lëndë që mund t'i rrisin nivelet e teofilinës, siç janë: allopurinoli, beta – bllokuesit (jopërzgjedhës), kalçibllokuesit, cimetidina, kontraceptivët që merren nga goja, kortikosteroidet, disulfirami, efedrina, vaksina e gripit, interferoni, makrolidët, meksiletina, kinolonet, tiabendazoli, hormonet e tiroides, izoniazidi, fluvoksamina, deferasiroksi.

Karbamazepina dhe diuretikët e ansës edhe mund t'i ulin edhe mund t'i rrisin nivelet e teofilinës.
Teofilina mund të ndikojë në barnat e mëposhtme: benzodiazepina, halotan, ketaminë, litium, miorelaksantë jodepolarizues dhe propofol.
Kjo listë ndërveprimesh nuk është e plotë. Ekzistojnë edhe barna të tjera që mund të ndërveprojnë me Eufiline.

Marrja e Eufiline me ushqim dhe pije

Drazhetë Eufiline 100 mg duhet të merren pas ushqimit.

Shtatzënia

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar!
Teofilina e kalon placentën, si dhe është raportuar irritueshmëri dhe apne tek të porsalindurit. Prandaj Eufiline nuk duhet të merret përveçse në rastin kur nevoja për të e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet fetusi. (Kategoria C).

Ushqyerja me gji

Teofilina kalon në qumështin e gjirit dhe ndonjëherë mund të shkaktojë irritim ose shenja të tjera të toksicitetit në foshnjat që ushqehen me gji, prandaj Eufiline nuk duhet të merret përveçse në rastin kur nevoja për të e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet foshnja. Në raste të tilla, ushqimi i fëmijës me gji duhet të bëhet menjëherë përpara marrjes së barit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna nëse Eufiline ndikon në aftësinë për të drejtuar automjetet dhe përdorur makineritë.

Informacion i rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse të Eufiline

Drazhetë Eufiline përmbajnë sukrozë. Kontaktoni mjekun tuaj para se ta merrni këtë bar nëse jeni në dijeni se keni mungesë tolerance ndaj disa sheqernave.

3. SI TA MERRNI EUFILINE

Gjithmonë merreni Eufiline sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e këtij bari janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Eufiline është një bar me indeks të ulët terapeutik (doza terapeutike është pranë asaj toksike), ndaj dozimi i saj duhet të bëhet me shumë kujdes.

Eufiline – (202 mg + 50.5 mg) / 10 ml (2.5%) – tretësirë për injeksion:
Eufiline – (192 mg + 48 mg) / 2 ml (12%) – tretësirë për injeksion:

Eufiline mund të merret me injeksion ose perfuzion të ngadaltë në venë nën monitorim të kujdesshëm.
Eufiline duhet të jepet me injektim shumë të ngadaltë në venë (për të paktën 20 minuta).
Gjatë përdorimit intravenoz duhet të matet përqëndrimi i teofilinës në gjak.
Duhet shmangur dozimi i tepërt në pacientët obezë si dhe doza duhet të llogaritet në bazë të peshës ideale trupore për gjatësi.
Tek të rriturit dhe fëmijët, të cilët nuk kanë marrë teofilinë, aminofilinë, ose barna të tjera që përmbajnë ksantina, doza e ngopjes është 0.6 – 3.1 mg / kg peshë trupore, e marrë me injeksion ose perfuzion të ngadaltë në venë përgjatë 20 deri 30 minutave.
Në varësi të gjendjes së pacientit, doza mbajtëse është:
Të sëmurët që nuk pijnë duhan, me injektim në venë: 0.5 deri 0.7 mg / kg peshë / orë.
Të moshuarit dhe të sëmurët me cor pulmonar, me injektim në venë: 0.3 deri 0.6 mg / kg peshë / orë.
Të sëmurët me insufiçiencë kardiake kongjestive, me injektim në *venë:* 0.1 deri 0.5 mg / kg peshë / orë.
Fëmijët 9 deri 16 vjeç dhe të rinjtë që pijnë duhan, me injektim në *venë:* 0.8 deri 1 mg / kg peshë / orë.
Fëmijët 1 deri 9 vjeç, me injektim në venë: 1 deri 1.2 mg / kg peshë / orë.

Eufiline – 100 mg – drazhe:
Të rriturit që nuk pijnë duhan: 3 mg / kg peshë, çdo 8 orë.
Të moshuarit dhe të sëmurët me cor pulmonar: 2 mg / kg peshë, çdo 8 orë.
Të sëmurët me insufiçiencë kardiake kongjestive: 1 deri 2 mg / kg peshë, çdo 12 orë. Fëmijët 1 deri 9 vjeç: 4 mg / kg peshë, çdo 6 orë.
Fëmijët 9 deri 16 vjeç dhe të rinjtë që pijnë duhan: 3 mg / kg peshë, çdo 6 orë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Eufiline

Në qoftë se keni marrë më shumë Eufiline se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Gjatë mbidozimit me Eufiline mund të shfaqet toksicitet prej saj.
Simptomat e mbidozimit janë: hipotension, hipokalemi, acidozë metabolike.

Në qoftë se harroni të merrni Eufiline

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Eufiline mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston ato.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.

Efektet e padëshiruara që mund të japë Eufiline janë si më poshtë:

- çrregullime gastroduodenale (të përziera, të vjella, anoreksi, diarre, refluks gastroezofageal, dhimbje epigastrike);
- çrregullime kardiovaskulare (palpitacione, takikardi, hipotension, aritmi);
- çrregullime në sistemin nervor qendror / çrregullime psikiatrike (irritim, dhimbje koke, pagjumësi, kontraksione, konfuzion, ankth, marrje mendsh;
- çrregullime respiratore (takipne, ndalim i frymëmarrjes);
- çrregullime të shikimit;
- çrregullime të metabolizmit dhe të të ushqyerit (nivele të ulta të kaliumit, fosfatit ose kripërave në gjak, hiperglicemi, hiperuricemi, ndryshime të nivelit të lipideve);
- çrregullime të lëkurës dhe indit të nënlëkurës (rash, rash makulo-papulare, eritemë, prurit, urtikarie, dermatit eksfoliativ, sindromë Stivens-Xhonson);
- janë konstatuar edhe: proteinuri, diurezë, ethe, skuqje e fytyrës, sekretim jonormal i hormonit antidiuretik.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI EUFILINE

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos përdorni Eufiline pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim!
Të ruhet nën 25°C.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban tretësira për injeksion Eufiline 2.5%
Lëndët aktive janë teofilinë dhe etilendiaminë.
Çdo ampulë 10 ml përmban 202 mg teofilinë dhe 50.5 mg etilendiaminë.
Lëndët ndihmëse: klorur natriumi dhe ujë për injeksion.

Çfarë përmban tretësira për injeksion Eufiline 12%
Lëndët aktive janë teofilinë dhe etilendiaminë.
Çdo ampulë 2 ml përmban 192 mg teofilinë dhe 48 mg etilendiaminë.
Lëndët ndihmëse: ujë për injeksion.

Çfarë përmbajnë drazhetë Eufiline 100 mg
Lënda aktive është aminofilina.
Çdo drazhe përmban 100 mg aminofilinë.
Lëndët ndihmëse: fosfat kaliumi bibazik, amidon, talk, glikolat natriumi i amidonit, stearat magnezi, sukrozë, xhelatinë, povidon, dioksid titani, karbonat kalçiumi, oksid hekuri i verdhë, oksid hekuri i kuq, oksid hekuri i zi, indigo karminë, benzoat natriumi, llak, dyll karnaube dhe dyll blete i bardhë.

Përmbajtja e paketimit:
Tretësira për injeksion Eufiline 2.5%:
Kuti me 10 ampula.

Tretësira për injeksion Eufiline 12%:
Kuti me 10 ampula.

Drazhetë Eufiline 100 mg:
Kuti me 60 drazhe.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.
Përmbajtja.
Kujdes.
Tretësirë për injeksion.
Forma e tabletës

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Skënder Vila"
Tel.: +355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.